

MIRATOHET
DREJTORIA E RAJONIT QENDER PERENDIM
TIRANE

DREJTORI
ERION KOKA

RELACION TEKNIK
(PROJEKT ME PERSHKRIM)

Mirëmbajtje me performancë :”Shirgjan (K/Rr.Nr.70) – Llixha, Llixha – Kaçivel (Gramsh) , Mjekës – Uzinë, Cërrik (Kryq Belsh) – Shalës – Belsh, Shtërmën – RadioStacion(të dy stacionet)” (35.7 km) (Kontrata 5)

• **Qëllimi i Shërbimeve që do kryhen**

Shërbimet që do mundësohen përfshijnë gjithë veprimtaritë, fizike dhe të tjera, që duhet të kryhen, sipas përputhshmërise së tyre me Nivelet e Shërbimit dhe kriterin e caktuar të realizimit të tyre të performancës, sipas Specifikimeve Teknike.

• **Segmentet që mbulon kontrata**

Nr. Rrugës	Indeks	Emërtimi i Rrugëve	Tipi rrugës	Gjatësia totale (km)
		MIRËMBAJTJE RUTINË		
71	6/1	Shirgjan (K/Rr.Nr.70) - Llixha	SHLH	6.6
71	6/2	Llixha – Kaçivel (Gramsh)	SHLWH	14.4
88	6/3	Mjekës - Uzinë	SHL	1.3
58	7/1	Cerrik (Kryq Belsh) – Shalës – Belsh	SHL	10.4
ska	7/5	Shtërmën – RadioStacion(të dy stacionet)	SFL	3.0
		GJATESIA KM KONTRATA 5		35.7

Shënim: SFL – rrugë në terren fushor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore, SHL – rrugë në terren kodrinor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore, SHLM – rrugë në terren kodrinor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore me risk mesatar, SHLWH – rrugë në terren kodrinor me një karrexhatë me mirëmbajtje dimërore me risk të lartë, SMTWM – rrugë në terren malor me një karrexhatë me mirëmbajtje dimërore me risk mesatar.

• **Kusht i veçantë**

Për çdo rast, nga kontrata do të zbriten segmente të saj nqs do të përfshihen në investim (rikonstruksion) apo projekte të tjera të Autoritetit Rrugor Shqiptar.

• **Sinjalistika dhe siguria rrugore**

Mirëmbajtja e sinjalistikës dhe siguria rrugore (barrierat) do të fokusohet tek riparimi dhe rifreskimi e asaj ekzistuese.

- **Përshkrimi i zonës ku ndodhet rruga**

Shirgjan (K/Rr.Nr.70) – Llixha

Ky segment rrugor është pjesë e rrugës nr. 71.

Është segment me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.

Shtresat asfaltike janë në gjendje pjesërisht të mirë.

Kanalet anësore dhe tombinat kanë nevojë për riformim dhe pastrim.

Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për rifreskim dhe zëvendësime. Në urën e Llixhes janë të demtuara

trotuaret, parmaket dhe në 2-3% të trareve ka zbulim të hekurit. Rruga është në terren kodrinor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore me risk mesatar.

Niveli i kërkuar i shërbimit “mesatar”.



Llixha - Kaçivel (Gramsh)

Ky segment rrugor është degëzim majtas i rrugës nr. 70, Elbasan – Cërrik.

Është segment me një karrexhatë me dy kahe lëvizje.

Shtresat asfaltike janë shumë të demtuara, trupi i rruges ka cedime, gerryerje, shembje dhe prishje të veprave të artit (mure mbajtes e prites, shpatulla urash, parmaket dhe bordura) etj. Segmenti ka nevojë për rikonstruksion (investim) nga ARrSh.

Kanalet anësore dhe tombinat kanë nevojë për pastrim të pjesshëm.

Sinjalistika dhe siguria duhet të bëhet për gjatë gjithë segmentit duke përfshirë ato horizontale / vertikale , gurdrela dhe parmaket urash.

Rruga është në terren kodrinor me një karrexhatë me mirëmbajtje dimërore.

Niveli i kërkuar i shërbimit “minimum”.



Mjekës – Uzinë

Ky segment rrugor është degëzim majtas i rrugës nr. 70, Elbasan – Cërrik.

Është segment me një karrexhatë me dy kahe lëvizje. Shtresat asfaltike janë në gjendje të mirë me nevoja të pakta për riparime. Kanalet anësore dhe tombinot kanë nevojë për pastrim të pjesshëm.

Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për rifreskim dhe zëvendësime të pjesshme.

Rruga është në terren kodrinor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore.

Niveli i kërkuar i shërbimit “i mirë”.



Cerrik – Shalës – Belsh

Cërrik (k/Belsh) – Shalës – Belsh

Këto segmente rrugore janë pjesë e rrugës nr. 58, përshkojnë zona rurale. Janë segmente me një karrexhatë me dy kahe lëvizje. Shtresat asfaltike janë në kushte të mira. Kanalet anësore dhe tombinot kanë nevojë për pastrim të pjesshëm.

Sinjalistika dhe siguria rrugore kanë nevojë për rifreskim dhe zëvendësime të pjesshme.

Rruga është në terren kodrinor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore.

Niveli i kërkuar i shërbimit “i mirë”.



Shtërmen - RadioStacion


Ky segment rrugore është degëzim djathtas i rrugës nr. 59, Cërrik – Gramsh.

Është segment me një karrexhatë me dy kahe lëvizje. Shtresat asfaltike janë në gjendje jo të mirë me nevojë për riveshje rreth 1 km rrugë, pjesa tjetër ka nevojë të pakta për riparime. Kanalet anësore dhe tombinot kanë nevojë për pastrim të pjesshëm.

Siguria rrugore kanë nevojë për sinjalistike vertikale .

Rruga është në terren fushor me një karrexhatë pa mirëmbajtje dimërore.

Niveli i kërkuar i shërbimit “mesatar”.



Përgatitën

Rajmonda Levanaj

Brunilda Kodra

Xhevdet Mulaj

Donika Mihali

Xhuljana Shehu

Ismail Ruçi

Mondi Sako